



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

P R O J E K T L I G J

Nr. ____ / 2018

PËR

**NJË NDRYSHIM DHE NJË SHITESË NË LIGJIN NR. 9948, DATË
7.7.2008 “PËR SHQYRTIMIN E VLEFSHMËRISË LIGJORE TË
KRIJIMIT TË TITUJVE TË PRONËSISË MBI TOKËN
BUJQËSORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 81 pika 1, dhe 83 pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozim të deputetit Erjon Braçe

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr. 9948, datë 7.7.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar bëhen një ndryshim dhe një shtesë si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 17, bëhen ndryshimi dhe shtesa, si më poshtë vijon:

shkronja c), riformulohet me këtë përmbajtje:

“c) Përdorues faktik të tokës bujqësore, në kuptim të këtij ligji, konsiderohen familjet bujqësore apo individët që kanë qënë banor të

komunës apo bashkisë në datën 1.8.1991, të cilët nuk janë pajisur me aktin e marrjes së tokës në përdorim ose në pronësi dhe faktikisht e përdorin tokën bujqësore.”

Pas paragrafit të tretë të shkronjës ç), shtohet paragrafi i katërt me këtë përmbajtje:

“Përdoruesit e tokës bujqësore në fshatrat e ish-kooperativave bujqësore, të cilët disponojnë tokë bujqësore në përdorim në zbatim të pikës 3, të vendimit nr. 255, datë 2.8.1991, të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore”, të ndryshuar, të regjistruar në aktin e marrjes së tokës së tyre në përdorim, e përfitojnë tokën bujqësore në pronësi sipas përcaktimit të pikës 2, të këtij vendimi, por pa kaluar normën për frymë të aplikuar nga komisioni i ndarjes së tokës në fshatin përkatës. Për këto përdorues nuk zbatohen dispozita e nenit 4 të këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

GRAMOZ RUÇI